

## **Figura të Ndritura Kombëtare: - Faik Shatku Përfaqses i shquar i Jurisprudencës Shqiptare**

**Shkruar nga: Saimir Shatku**



Institucionet juridike dhe Jurisprudenca shqiptare e fillim shekullit të XX (1924-1939) ka patur ne mesin e saj, ndër sa e sa juristë te diplomuar në shkollat perëndimore, dhe një personalitet si Faik Shatku. Lindi në Dibër të Madhe më 12.06.1889 në një familje patriotike dhe atdhetare, ku perfundoi edhe shkollen qytetese, kurse arsimin e mesëm e ndoqi në shkollën tregëtare franceze, në Selanik. Duke qënë se familja e tij kishte emigruar në Turqi, si pasojë e pushtimit të Dibrës gjatë Luftes se Parë Ballkanike, shkon në Stamboll pranë familjes për të vazhduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Sutudimeve të Stambollit. Pranë këtij Fakulteti u diplomua dhe mbrojti doktoratën. Në Arkivin e Shtetit Shqiptarë, fondi 803 në dosjen e nëpunësve të lartë civilë jepet saktësisht jetëshkrimi dhe biografia e Faik Shatkut. Ku ndër të tjera parashtrohen elementet e gjëndjes civile dhe gjyqsore si: nëpunësia, vendi i emërimit, rroga mujore, shënimet mbi sjelljet morale të nëpunësit. Në fillim te vitit 1924 njëri nga shqiptarët e arsimuar, largohet familjarisht nga Turqia për t’u vendosur përfundimisht në Tiranë.



Nga e majta: Faik Shatku, Thoma Orollogaj, Kostaq Kotta, Musa Juka, Kolë Thaçi

Në librin me autor gjermanin Michal Schmid-Neke, i cili titullohet “ Lindja dhe Perëndimi i diktaturës Mbretërore në Shqipëri 1912-1939 ” botuar në Oldenburg në vitin 1987 ndër të tjera shkruhet biografia e shkurtër e Faik Shatku. Ky autor jep

të dhëna duke na treguar se Faiku Shatku ka qënë anëtarë i kabinetit të z. Kotta, në dy qeveritë e fundit para pushtimit të Shiperise nga Italia fashiste. Një herë si Ministër i Arsimit Kombëtar dhe më pas si Ministër i Drejtësisë. Në dt. 14.05.1924 Faik Shatku u emërua anëtar i gjykatës së shkallës së parë në qytetin e Elbasanit, e pastaj në Korçë. Në 11.02.1925 u emërua prokuror i gjykatës së shkallës së parë në Tiranë. Gjithashtu, Faik Shatku ka drejtuar dhe shoqatën e Kryqit të Kuq Shqiptar si kryetar i saj, nga viti 1930 deri në vitin 1932. Gjithashtu ishte gjyqtar, prokuror dhe kryeprokuror në Tiranë. Me 23.03.1925 u emërua këshilltar i ministrit të drejtësisë, detyrë të cilën e mbajti deri në vitin 1929. Gjatë kësaj kohe ai ndërmoi një sërë reformash për shndrimin e ministrisë së Drejtësisë nga një institucion i veprimit burokratik në një institucion vendimarrës, inspektues, organizues të sistemit gjyqësor dhe kontrollues. Në Gazetën “Demokratia” organ i shtypit të qytetit të Gjirokastrës, më 24 korrik 1926 në artikullin:



### Faik dhe Izet Shatku (Dibra)

“ Një intervistë me këshilltarin e ministrit të Drejtësisë” theksohej mendimi përparimtar i Faik Shatkut për organizimin e ri gjyqësor, në hapjen e gjykatave në zonat më të thella malore si dhe organizimin e ri të sistemit gjyqësor, në bazë të trupit gjykues me zhuri. Në pyetjen e bërë nga drejtori i gazetës “Demokratia“, se pse nuk shihet i arsyeshëm krijimi i zburisë ? Faik Shatku përgjigjet se “Sa për çështjen e zburisë që pyesni, kjo pyetje kaq e vogël ka një rëndësi vitale në degën e drejtësisë. Zburia barazohet me zhvillimin psikologjik të një populli. Ndër viset e qytetëruara, si për shembull në Francë, në këto kohët e fundit, ka një antikurant kunder këtij sistemi. Atje kur të gjithë mjetet e qytetëruara kanë gjetur gradën më të lartë të përparimit, ky sistem duke qënë se po luftonte; nëpër viset tona ku jemi në fillimin e organizimit e të përmisimit të ligjeve dhe duke marrë parasysh psikologjinë e vendit, adoptimi i një sistemi të tillë, si mbas mendimit tim, thekson Faik Shatku, sot për sot nuk shihet i arsyeshëm.” Duke qënë se mendimi juridik dhe

qëndrimi i mbajtur nga Faik Shatku përse i përket drejtësisë me juri ishte tepër përparimtar për kohën, gazetari avancoi qëndrimin e tij në lidhje me një tjetër pyetje, e cila i referohej reformimit të gjykatave të Sheriatit, ai theksoi se: Në rastin e përmirësimit të dispozitave të kodit civil mund të merren parasysh dispozita të veçanta, për këtë qëllim mbasi të studiohet kthjelltësisht zakoni dhe psikologjia e popullit.” Shihet me së qarti se idetë e reformimit të pushtetit gjyqsor që kishte Faiku për sistemin e gjykatave të sheriatit, ishin ato që ky sistem përderisa pasqyronte interesat e popullsisë shqiptare dhe dëshirat e tyre duhet të egzistonin sepse ky sistem pasqyron ndërgjegjen dhe psikologjinë originalis të popullit. Gjithashu është më i përshtatshëm për të zgjidhur kontraditat dhe interesat e qytetarëve. Po në këtë vit emërohet anëtar i Këshillit të Shtetit dhe më pas zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit. Këshilli i Shtetit duke qënë një institucion i përshtatur nga vendet perëndimore kishte kompetenca të larta në drejtimin e kontrollit juridik, ekonomik, financiar dhe shoqëror të vendit. Qëndrimi që mbajti Faik Shatku në krye të këtij institucioni ishte i tipit, juris consultum. Pra qëndrim kontrollues dhe konsultues të vendimeve dhe të projekt-amendamenteve ligjore dhe të akteve nënligjore. Po ashtu ishte Kryeprokuror i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryeprokuror i Përgjithshëm i Gjyqit Ushtarak të Naltë deri në vitin 1936 kur u emërua si Minister i Arsimit Kombëtar. Në zgjedhjet për Asamblenë Parlamentare, të Legjislaturës së III-të, e cila përbëhej nga një dhomë, më 10.02.1937 u zgjodh deputet i prefekturës së Elbasanit, së bashku me intelektualë të tjerë dibranë si, Abdurahman Dibra, Fiqiri Rusi, Hafiz Xhemali, Jashar Erebara këta në prefekturën e Dibres, si dhe *Izet Shatku* (Dibra), në prefekturën e Durrës-Tiranë. Kjo gjë pasqyrohet dhe në periodikun e kohës së Mbretërisë ashtu dhe në botimin e Kuvendit të Shqipërisë, të vitit 2005 me titull:

“ Ligjvënësit Shqipëtarë 1920-2005 ” ku ndër të tjera jepen lista emërore e deputetëve të ndarë në rang prefekturë ku Faik Shatku, përfaqsonte prefekturën e Elbasanit.

Më 01.11.1936 u emërua Ministër i Arsimit Kombëtar ( Edukacionit ), post të cilin e mbajti deri në vitin 1938, vit në të cilin formohet kabineti i fundit qeveritar, i kryesuar nga kryeministri Koço Kotta. Gjatë kësaj periudhe Faik Shatku dha ndihmesë të shquar në zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar. Ai për të realizuar ecurinë e punëve në institucionin që drejtonte angazhoi nëpunësa të arsimuar në vendet perëndimore, si dhe reformoi sistemin pedagogjik duke e kasifikuar atë në shkolla foshnjore, fillore, dhe të mesme. Ai i dha rëndësi zhdukjes të analfabetizmit në përgjithësi, si dhe emancipimit të vajzave në shoqëri. Ngjarje e rëndësishme për kombin Shqiptar ishte dhe kthimi në atdhe i eshtrave të poetit të madh shqiptar Naim Frashërit në vitin 1937, me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarsisë dhe të 37 vjetorit të vdekjes së tij. Ky veprim u propozua nga ministri i Arsimit Faik Shatku, i cili kryesonte komisionin e kthimit të eshtrave të poetit tonë kombëtarë së bashku me Komandantin e Përgjithshëm të Xhandarmërisë kolonel *Shefki Shatku*. Faik Shatku, i çuditur nga pritja madhështore, nga një pritje e papritur, që as programi, as rregulli s’e kishte parashikuar, përshëndetet prej z. Musa Juka dhe, dorzon “eshtrat” të mbyllura në një arkivol me vija kuq e zi dhe me një zë të mallëngjyer tha: “Ora e madhe me të cilën erdh që idealet t’ona të dalin në dritën e begatëshme që vendi, Drejtësia dhe Liria mund të japin, erdh...Naim! Shiko si të

pret Shqipëria e tanë kryenaltë. Naim të njoftoj ty dhe tanë botës shqiptare se kjo vepër i kushtohet atij që çdo sakrificë të bamun për Atdhe. Le të qetohet pra shpirti yt i ndritur që erdhi për t'u qetue në tokën e Atdheut...”

Me 01.06.1938 me ndryshimet që u bënë në qeverinë e kryeministrit Koço Kotta, Faik Shatku u mandatua si Ministër i Drejtësisë, post të cilin e mbajti deri në 07.04.1939. Gjatë kësaj periudhe ai nisi reformën për depenalizimin e disa veprave penale, të cilat rrethanat e kohës nuk i shihnin si sjellje me rrezikshmëri të lartë shoqërore, shfuqizoi disa ligje të vjetëruara si dhe riformatoi legjislacionin procedural penal dhe civil. Rol të rëndësishëm Faik Shatku i dha dhe hapjes së Institutit Juridik, e cila ishte një shkollë 2-vjeçare në të cilën përgatiteshin me kulturë juridike kuadrot dhe specialistët në administratën gjyqësore dhe shtetërore të vendit.

Në gazetën periodike “Java” të dt. 02.06.1938 në artikullin “ Plotësimi i kabinetit Koço Kotta “ ministrant e rinj....shkruhej ndër të tjera se Z. Faik Shatku, Që kur erdhi në fuqi kabineti i sotshëm drejtoi me një zotësi të çquar dikasterin e arsimit. z. Shatku si ministër i Arsimit Kombëtar, ka treguar një veprimtari të lavdërueshme dhe një drejtësi të pashoqë. Shumë pa-drejtësira që rrethanat e kohës i kishin shkaktuar, zoti Shatku i vuri në vënd. Eshhtë një nga juristat t'onë të shquar dhe na jep çdo shpresë se dhe në dikasterin e drejtësisë do të tregojë një veprimtari dobiprurëse për vëndin tonë. Si Ministër i Drejtësisë, Faik Shatku u mor gjerësisht me përthithjen e legjislacionit modern europian dhe përafrimin e sistemit gjyqësor shqiptar me ato të tipit Francez, Italian dhe Gjerman. Një rol tepër të rëndësishëm në atë kohë luajti dhe diplomacia shqiptare, përmes ambasadorëve të jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë. Rol të rëndësishëm në zhvillimin e drejtësisë penale shqiptare kanë luajtur dhe lidhja e një sërë marrveshjesh dhe konventash, kundër kriminalitetit, ekstradimit, dhe përmisimit të sistemit penitenciar në Shqipëri. Me interes ishte dhe ratifikimi nga parlamenti monarkist shqiptarë i të parës Konventë midis “Mbretërisë Shqiptare dhe Republikës Cekoslllovakë mbi Ekstradimin dhe ndihmën Gjyqësore.” Kjo konventë mbante firmën e Ministrit propozues të Drejtësisë z. Faik Shatku ( d.v ). Qëllimi i kësaj konvente ishte i përbashkët : Për ekstradimin e keqbërësve, për ekstradimin në transit ( kalim ), dhe për ndihmën gjyqësore reciproke në çështjet penale. Kjo marrveshje ndahej në dy krerë: Ku kreu i pari fliste për ekstradimin e keqbërësve, ekstradimin dhe ndjekjen e nënshtetasve si dhe pjesa për fajet në të cilën nuk i shtrinë efektet ekstradimi. Kurse pjesa e dytë, shtjellonte ndihmën gjyqësore në çështjet penale. Duke qënë dhe deputet në legjislaturën e III-të të Asamblesë Parlamentare merr pjesë në një sërë diskutimesh në lidhje me projekt-ligjet, paketat fiskale, amendamentet për reformimin e institucioneve dhe të ligjit për sistemin gjyqësor të vendit. Ndërsa përsa i përket parandalimit të kriminalitetit në shoqërinë e kohës, i përmbahej formulës cura + corrigenda (d.m.th, shërim dhe parandalim + drejtësi restauruese ). Jep konsulta sesi duhen zbatuar me korrektësi qarkoret dhe udhëzimet ministrore. Ishte për një sistem gjyqësor të decentralizuar në shkallë prefekturash dhe nënprefekturash.. Kjo gjë pasqyrohet dhe në shtypin e kohës. Në gazetën “ Drita ” të 12 marsit 1939 nën titullin “ Bisedimet e Parlamentit “ thuhet se: Z. Faik Shatku, Ministër i Drejtësisë propozoj që neni 1 i projekt-ligjit në bisedim të ndryshoj. Sipas tij, Gjykatat paqtuese të Shijakut dhe të Malsisë së

Madhe të suprimueme në ligjin datë 25.03.1935, duhet të rikrijohen me juridiksionin e prefekturave omonime ashtu siç kanë qënë me ligjin mbi organizimin e drejtësisë. Pra siç shihet ai ishte për një juridiksion i cili vetëorganizohej në shkallë prefekturë pa ndikimin e drejtëpërdrejtë të politikës. Nën titullin “ Fjalimi i Shk. Tij Ministrin të Drejtësisë z.Faik Shatku, mbajtur me gojë në darkën e 30 gushtit, të shtruar prej Qeverisë Mbretërore në hotel Internasional“ do ta niste kryeartikullin e saj Gazeta “Drita”, e 1 shtatorit të vitit 1938. Ishte një ngjarje e pazakontë, për arsye se dinastia Zogolli dhe Shqipëria festonin 10-vjetorin e themelimit të Mbretërisë Shqiptare. Për nder të kësaj ngjarje historike, u shtrua një darkë e cila u prijë nga fjalimi i z. Faik Shatku. Në ligjeratën e tij ai theksoi “sesi populli shqiptar kalojë nga një fazë e mbretërimit të artë të Skënderbeut, në një tjetër periudhë të mbretërimit të shëndritshëm të Mbretit Zog. Përparime të çuditshme janë bërë në gjirin e shoqërisë sonë kombëtare, si në konsolidimin e shtetit, në lartësimin e ndërgjegjes kombëtare, në sigurimin e një qetësie shembullore që ka fituar rekord të përbotshëm. Në artikullin e shkruar nga z. Fabian Morava, të dt. /.../2003 në revistën Klan, me titull

“ Kur ndërtohej Tirana “ ndër të tjera citon se “ Abedin Nepravishta u përket atyre personaliteteve të pakta të periudhës së Pavarësisë së vitit 1912-1939, si: Hil Mosi, Mirash Ivanaj, Faik Shatku të cilët qëndruan asnjëherë në çështjet e ideologjisë politike”. Ndërsa një tjetër bashkombas dhe bashkëpatriot i Faik Shatkut, z. Xheladin Krifca do të shkruaj në gazetën “ Ndryshe” të dt./.../2007 në artikullin me temë :” Horizonte të reja në arsimin kombëtar” të cilën ia kushton veprës dhe kontributit të Faik Shatkut, si Ministër i Arsimit Kombëtar. Ndër të tjera ai shkruan se: “ Faik Shatku, i paisur me një kulturë juridike të shëndoshë, ai ka derdhur gjithë energjitë e tija mendore, në të mirë të atdheut. Faiku nuk ka bërë asnjëherë kompromis me rregjimet apo sunduesit që kanë shkelur vëndin tonë”.

Dhe është e drejtë që të përmëdim se në ndryshim nga kolëgët dhe politikanët bashkëkombas të tij, të cilët ditën që t’i serviloseshin armikut dhe të jënë përsëri të parët në postet ministrore dhe në ofiqe, Faiku deshiroj që të qëndronte neutral dhe të mos merrte pjesë në jetën politike gjatë pushtimit të Shqipërisë nga trupat nazi-fashiste. Me pushtimin e Shqipërisë, më 7 prill 1939 nga Italia fashiste, largohet së bashku me mbretin Zog I dhe më grupin shoqërues për në Turqi. Në muajin mars të 1940 kthehet në atdhe, por fashistët e internojnë në Itali, pa asnjë motivacion. Në fillim e mbajnë në burgun e Barit, e pastaj në atë të Bergamos. Në maj të vitit 1941 lirohet nga burgu dhe kthehet në atdhe. Pas kthimit në atdhe, ai emërohet Kryetar i Komisionit të Kontrollit pranë Ministrisë së Financave. Ndërroi jetë në 15.04.1946 në Tiranë, në moshën 57-vjeçare, një nga ideuesit, krijuesit, dhe konsoliduesit, e institucioneve të Drejtësisë dhe të Jurisprudencës Shqiptare, në shtetin e porsa krijuar Shqiptar.

**P.S:- Të dhënat janë marre nga arkiva e shtetit shqiptar, marre nga nipi i babit tim, Saimir Shatku.**

**LL.M ( Legium Magister )**

**Fakulteti i Drejtësisë**

**Universiteti i Studimeve të Torinos**

**Me nderime, stërnipi i Z. Faik Shatku-Engjëll Buxhaku**

**Përgatiti për botim në web-faqen:[www.egriu.se](http://www.egriu.se), rubrika: Artikuj- Dritan Egriu**